

FJALA E DEPUTETES ERALDA BANO

E ENJTE 14 PRILL 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Sot mora shkas të dal para jush, pasi ditën e djeshme në Komisionin e Medies dhe Mjeteve të Informimit u prezantuam me një vendim të Këshillit të Ministrave për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Medie dhe Informim.

Të nderuar qytetarë,

Ky vendim është institucionalizim i ERTV-së. Ky institucion do të jetë në varësi të plotë të Kryeministrit, si çdo gjë tjetër e centralizuar në këtë vend. Zoti Endri Fuga është drejtues i makinerisë së propagandës qeveritare, e cila sipas pikës 2 të dispozitave të përgjithshme të kësaj VKM-je, do të financohet pikërisht nga buxheti i shtetit me donacione dhe burime të tjera të ligjshme. Thënë shkurt, kjo agjenci do të përpajë taksat e qytetarëve shqiptarë për t'i shërbyer Edi Ramës dhe qeverisë së tij, propagandës së tyre dhe absolutisht minimumit të demokracisë dhe fjalës së lirë. Sipas kësaj VKM-je, në shkronjën "dh", pika 10 e çështjes 3 thuhet: "Agjencia ka për funksion të vëzhgojë publikimet e medies dhe mjetet e komunikimit masiv për të evidentuar perceptimin dhe qëndrimin e publikut ndaj veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore". Praktikisht, ky institucion do të shndërrohet në një megastrukturë me 69 të punësuar, me siguri patronazhistë, ku do të vëzhgohen me kujdes të gjitha mediet dhe mendimet e qytetarëve që shkojnë kundër qeverisë.

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Ky vendim dhe kjo agjenci fyen inteligjencën e qytetarëve shqiptarë, pasi do të trajtohet si mjet i edukimit të qytetarëve. Si mund të imagjinohet që një institucion me individë të panjohur për kontribute në edukim, të funksionojë si mjet edukimi? Kjo është tallje dhe pafytyrësi e legjitimuar me qytetarët shqiptarë. E them me siguri të plotë se kjo është maskradë, pasi më kujton "riedukimin" që Edi Rama i përmendi me arrogancë gazetares Ambrozia Meta. "Çdo fëmijë ka fytyrën e prindërve të tij" dhe jam e bindur se kjo shprehje e urtë popullore personifikohet në situatën aktuale. Kjo agjenci do të ketë arrogancën dhe fytyrën e Edi Ramës. Gjithashtu, në çështjen 3, pika 10, shkronja "dh" thuhet: "Agjencia boton, harton dhe shpërndan broshura manuale këshilluese, informuese, materiale audio-vizuale dhe çdo material tjetër të disponueshëm falas për publikun edhe në internet". Ky është masivizim i propagandës dhe sot është dita kur hijet e patronazhistëve do të dalin me zë, me figure dhe nuk do të jenë më nën rrogë.

Pyetja ime është shumë e qartë dhe e thjeshtë: kujt do t'i shërbejë kjo agjenci? A nuk ka mjete të mjaftueshme informacioni që qytetarët të informohen? Kush do të jenë donatorët që do të financojnë agjencinë? Unë mendoj se pikërisht donatorët do ta përdorin për përfitimet e tyre personale, sepse ata qëndrojnë pas Edi Ramës, janë përgjegjës për masakrën zgjedhore dhe për aferat kolosale korruptive, përfshirë inceneratorët, aferë për të cilën u vunë në dispozicion të gjitha mediet për ta shitur këtë krim gjigant ndaj shqiptarëve si një arritje të madhe. Faleminderit!